



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.1066/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të masës së sigurimit Marimanga shpk me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Marigona Berisha avokate nga Prishtina, ndaj kundërshtarit të masës së sigurimit Ndërmarrja Publike Lokale “Prishtina Parking” me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Lekë Kelmendi, për shkak të caktimit të masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërshtarit të sigurimit, të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Për Çështje Ekonomike, KE.nr.175/24 i datës 24.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 10.06.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e kundërshtarit të masës së sigurimit Ndërmarrja Publike Lokale “Prishtina Parking” me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr. 175/24 i datës 24.04.2024, ashtu që kjo çështje juridike kontestimore gjykohet si në vijim:

REFUZOHET në tërsi si i pabazuar propozimi për caktimin e masës së sigurisë i propozuesit të masës së sigurimit Marimanga shpk me seli në Prishtinë, ndaj kundërshtarit të sigurimit Ndërmarrja Publike Lokale “Prishtina Parking” me seli në Prishtinë, ashtu që ti Ndalohet kundërshtarit të sigurimit, që të bëjë ekzekutimin e sigurimit të ekzekutimit të tenderit me numër 600-23-6529-2-1-1 në shumën prej 21,978.00€ sipas policës numër 116053.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar, ka vendosur si në vijim: I.APROVOHET në tërsi si i bazuar propozimi propozuesit të masës së sigurimit Marimanga shpk, CAKTOHET masa e

sigurisë ndaj kundërshtarit të sigurimit Ndërmarrja Publike Lokale “Prishtina Parking”, ashtu që i NDALOHET kundërshtarit të sigurimit që të bëjë ekzekutimin e sigurimit të ekzekutimit të tenderit me numër 600-23-6529-2-1-1 në shumën prej 21,978.00€ sipas policës numër 116053, II. Masa e sigurimit mbetet në fuqi deri sa mos të jepet vendim tjetër mbi masën e sigurimit

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka paraqit kundërshtari i masës së sigurimit, për shkak se kërkesa e palës propozuese për caktimin e masës së sigurimit nuk i ka plotësuar kushtet sipas nenit 297 të LPK-së, nuk ka arrit të argumentoj si të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo drejtës subjektive, i propozon uar Dhomës së Shkallës së Dytë që të aprovojë ankesën si të bazuar, dhe të anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr. 175/24 i datës 24.04.2024.

Kolegji i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi - propozuesi i masës së sigurisë Marimanga shpk me seli në Prishtinë, me datën 01.03.2024 pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi, dhe propozim për caktimin e masës së sigurisë ndaj kundërshtarit të sigurimit Ndërmarrja Publike Lokale “Prishtina Parking”, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme e sigurisë dhe t’i ndalohet kundërshtarit të sigurimit që të bëjë ekzekutimin e sigurimit të tenderit me numër 600-23-6529-2-1-1, në vlerë prej 21,978.00euro, sipas policës me numër 116053.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës dëgjimore me datë 27.03.2024 në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyëse, merr aktvendimin e atakuar, me të cilin Aprovon në tërësi si të bazuar propozimin e masës së sigurimit Marimanga shpk, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit. Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë thekson se kërkesa për caktimin e masës së sigurimit është e bazuar, dhe propozuesi i masës së sigurimit ka arritur të bëjë të besueshme ekzistimin e të drejtës së tij subjektive e po ashtu edhe ekzistimin e rrezikut se mos caktimi i masës së sigurimit do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit. Gjykata vendimin e referon në faktin se ekzekutimi i garancionit ka të bëjë në aktivitetin e prokurimit “shërbime për bartje të veturave me merimangë” e siguruar te KS Elsig, dhe kundërshtari i sigurimit nuk ka arritur ta vërtetojë faktin se është plotësuar njëri nga kushtet e përcaktuara në ekzekutimin e garancionit, përkatësisht që të njëjtit në këtë fazë të procedurës i takon e drejta për ekzekutimin e garancionit. Propozuesi ka arritur të tregojë faktet në të cilat mbështetet kërkesa e tij dhe i ka ofruar prova të besueshme gjykatës se në rast se masa e sigurimit nuk caktohet, ai do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme, dhe si rrjedhojë gjykata vendosi ta aprovoj propozimin për caktimin e masës së sigurimit meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 297 të LPK-së.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar, ashtu që gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhoma e Shkallës së Dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së dhomës së shkallës së parë.

Kolegji, në këtë gjendje të çështjes juridike, ka gjetur se aktvendimi i atakuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika, (n) të LPK-së, për arsye se aktvendimi i atakuar ka të meta për shkak se në arsyetim nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktvendimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës. Për më tepër gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar fare se si e ka krijuar bindjen për caktimin e masës së sigurimit ndaj kundër propozuesit të masës së sigurimit.

Kolegji, e mori këtë vlerësim juridik për arsye se me Nenin 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se:” Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së kësillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me

*ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”.*

Bazuar në dispozitat e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet ligjore sipas të cilave propozuesi duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës dhe rrezikun se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së propozuesit. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të atakuar nuk ka dhënë arsyetim lidhur me këtë fakt kontestues, se pse vështirësohet apo pamundësohet dukshëm realizimi i kërkesëpadisë nëse kjo masë e sigurisë nuk shqiptohet, nuk është provuar me asnjë provë materiale se ekzekutimi i garancionit për sigurimin e kontratës, do të shkaktonte dëm të pariparueshëm propozuesit të masës së sigurimit,

Prandaj, bazuar në të lartcekurat Kolegji, vlerëson se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuar me Nenin 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë, ndërsa vendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë është dashur të ndryshohet si në dispozitivin e këtij aktvendimi, pasi nuk ka bazë ligjore respektivisht nuk ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë me veprimet e saj do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit. Në këtë rast palët ndërgjyëse duhet të presin nga ana gjykatës vendimin meritor në këtë çështje, në mënyrë që të vërtetohet ligjshmëria e padisë së propozuesit-paditësit për kompensim dëmi ndaj kundërshtarit të masës së sigurimit. Gjithashtu, vendimi i Dhomës së Shkallës së Dytë për refuzimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit, nuk e prejjudikon çështjen kryesore, por ka të bëjë vetëm sa i përket ndalimit në ekzekutimin e garancionit sipas policës së sigurimit nr.116053 në shumë prej 21,978.00€, sipas Kontratës Publike Kornizë datës 04.08.2023, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Prandaj, bazuar në të lartëcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 nën pikën (e), nenit 208 dhe 209 par.1 nën pikën (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1066/2024 me datën 10.06.2024

Kryetari i kolegjit

Krenar Berisha